Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Muhamet Kurtishaj	**10.05.2022**	**18.05.2022**	**Nr.133/22**
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 06.05.2022, OE **"ORTU" SHPK** ka parashtruar ankesën me **nr.133/22**, kundër vendimit për **anulim** të dhënies se kontrates, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me pjese nderrimi per vinç hidraulik teleskopik Liebherr"** me nr. te prok. KEK-21-5233-111**,** iniciuar nga autoriteti kontraktues **Korporata Energjetike e Kosovës.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, **furnizim**, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **320.000,00 €.**

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, më Nr.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE të OE "ORTU" SHPK

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- Neni 48 i Ligjit te Procedures se Pergjitheshme Administrative

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta**.**

Me date 19 prill 2022 kemi pranuar Njoftimin per Anulimin e Dhenies se Kontrates, i datës 19.04.2022, me numer ë prokurimit KEK-21-5233-1-14. Perderisa me date 21.08.2021 ishte dorezuar Njoftimi per dhenien e Kontrates, me Titull dhe numer identifikues të aktivitetit të prokurimit "Funrnizim me pjese ndërrimi vinç hidraulik teleskopik Liebherr KEK-21- 52337144". Operatori Ekonomik kishte plotesuar të giitha kerkesat e specifikaara ne piken 6.4 te Dosjes së Tenderit si dhe specifikat e tjera të kerkuara ne po te njejtin dokument.

Rrjedhirrtisht, me date 10.10.2021 Autoriteti Kontrakbies ka publikuar Njofiimin per Vendimin per Dhenie te Korttrates me numer të prokurimit KEK-21-5233-1-1-1 per Funizim me pjese nderrimi per vinc hidmulik teleskopik Liebherr, tek Operatori Ekonornik, duke konfirmuar plotesimin e kritereve pier dhenie te kontrates. Sipas po të njëjtit njoftim Autoriteti Kontraktues ka caktuar daten 29.10.2021 per nenshkrimin, e Kontrates me vlere totale 319 264,21 euro. Tutje ne proresverbalin e hapjes sé Tenderit te dy zyrtaret e prokurimit nuk kane evidentuar asnje parregullsi qe do mund te krijonte baze per mos permbushje te kritereve nga ana e Operatorit Ekonornik të percaktuara ne procedurat e tenderimit. Duke u bazaar faktin qe Autoriteti Kontraktues kishte konfirmuar qe koha e liferimit ishte 120 dite, Operatori Ekonomik ne rnenyre që të ishte ne perputlije me afatin e liferimit ka bere rnenjehere porosine per pjesen e pare te furnizimit tek Furnitori në perputhje te plote me doktunentin e Autoriteti Kontraktues te dorezuar tek Operatori Ekonomik, Pjesa- II- Pershkrimi i cmimeve,,

perkatesisht porosine e pjeses se pare ne vleren totale prej 149,533.70 euro, ku në vleren e njejte eshte bere edhe garancioni bankar i leshuar per furnitorini. Gjithsesi, Autoriteti Korttraktues, kishte bere dy here kerkese per vazhdim te validitetit të ofertës furnizuese deri me daten 20.122021 dhe pastaj me kerkesen e dyte ishte vazhduar deri me date 21.032022 dhe perkundur fakit qe ne Njoftim per Dhenien e Kontrates data per nënshkrimin e kontrates ishte percaktuar data 29.10.2021, si dhe komunikimet e paleve te dates 19 dhe tetor 2021, ku eshte konfirmuar drafti final i kontrates, Autoriteti Kontraktues nuk ka perfunduar procesin formal te nenshkrimit kontrates. Operatori Ekonornik shume here ka kerkuar nga Autoriteti Korttraktues sqarime ne lidhje me vonesat e shkaktuara né nenshkrimhi formal te kontrates dhe ju ka !loft-Liar qe tashme kishte byre ne obligime financiare me Furnitorht, sepse tashme ishin perfunduar te gjitha procedurat administrative te parapara, perfshire konfirmimi i kontrates riga t dyja palest si hape perfundimtar,, veptirn ky i ciii ka si pasoje obligihele korttraktuale per te dyja palet. Perkunder ketij faith, Autoriteti Kontraktues perfurtdimisht me date 19.04.2022 ka publikuar Njoftimirt per Anulimin e Dhenies së kontrates, me arsyetimin se nuk eshtenë perputhje me nenin 65 te LPP.

Operatori Ekortomik brenda afatit ligjor ka dorezuar Kerkesen per rishqyrtirrt të Njoftimit per Anulimin e Dhenies së Kontrates, duke kërkua nga Autoriteti Kontraktues qe të përmbush obligintet ligjore dhe kontraktuale, meqe Operatori Ekortomik tashme kishte hyrë rte obligime me palet e treta per realizirnin e obligimeve të tij dhe dem financiar per vonesat e shkaktuara nga Autontett Kontraktues ne realizimin e objektit te kontrates, tashme vec i eshte shkaktuar Operatorit Ekonomik. Gjithsesi, me date 29 prill 2022 kerni prartuar njoftimin per refuzimin e kerkeses per rishqyrtim duke u bazuar ne arsyetimirt se tenderi nuk eshte rte pajtueshmeri me nenin 65, paragrafi 1 te UP-se, duke mos &ale arsyetim te plote se cilat rrethanra kane bere dosjen e tenderit të papranuethem, perkunder faktit qe dosja e tenderit ka kaluar te gjitha fazat dhe nuk eshte identifiku asnje shkelje. Perkunder faktit ge Autotiteti Kontraktues nuk ka dhene sgarime Njoftimin perAnulirn, konsiderojme qe OSHP gjate shqyrtimit të kesaj shkrese duhet të kete parasysh faktin qé Operatori Ekonomik dhe Autoriteti Kontrakhies kane qene ne marredhenie kontraktuale që nga viiit 2018 per fumizirtt me pjese nderrimi dhe servisimin e mekanizmit Liebherr kontrate komize me validitet 3 vjeqare, Ne kuader te obligimeve kontraktuaie qe rrjedhin nga kjo kontrate, Operatori Ekonomik sipas kerkeses se Autoritet Kontraktues, ka kryer shërbimin perkatesisht identifikimin e defekteve ne vmçin hidraulik teleskopik Liebherr. Rrjedhimisht Autoriteti Kontraktues pas evaulimit të dekkteve, per papsjet te cilat kane munguar dhe ka qene e pamundur nderrimi/zëvendësimi i tyre dhe nuk kane qene te perfshira ne kontratën e vitit 2018, ka vendosur që te publikoj tender te ri, ne nje proces krejtesisht ndaras nga marredhenia kontraktuale ekzistuese, procedure e re qe natyrisht meqë eshte ndaras ka dhe numër te ri identifikues. Autoriteti Kontraktues, perkunder faktit qe vet ka kerkuar nga Operatori Ekonomik qe ti kryej obligimet e tij kontraktuale dhe te* ofroj sherbimin sipas kushteve te kontrates së vitit 2018 e qe kishte objekt tjeter (ne proceduren tenderuese me numer té prokurimit KEK-21-5233-144- per Furnizirn me pjese nderrimi per vinc hidraulik teleskopik Liebherr), pas finalizimit te gjitha fazave tenderuese dhe njoftimin per dhenie té kortrates tek Operatori Ekonornik, pastaj konfirmimin e dates se liferimit dhe specifikave té tjera,, perfundimisht ne njoftimin per refuzimin. e Kerkeses per rishqyrtim eshte bazuar n arsyetimin se tenderi nuk eshte ne pajtueshmeri me nenin 65, paragrafi 1 te LPP-se. Pra, Autoritet Kontraktues gabirnisht po nderlidh dy proredura te ndryshrne tenderuese, dhe duke anashkaluar faktin jetik të këtij procesi qe vet Autoriteti Kontraktues ka hartuar dosjen e tenderit duke perfunduar të njëjtit me konfirmim te draftit final te kontrates bashke me Operatorin Ekonomik. Operatori Ekonomik nuk ka marr piese ne hartimin e dosjes tenderuese me numer te prokurimit KEK-21-5233-144, por qe Autotiteti Korntraktues si njedhoje e

shërbimit nga Operatori Ekonomik brenda komizave kontraktuale të tjera, po e penalizon Operatorin Ekonornik duke mos nenshkruar Kontraten per Fumizim me pjese nderrimi per vmcit hidraulik teleskopik Liebherr, perkunder faktit që asnje rrethane ndaluese nuk eshte identifikuar dhe per me teper jane permbushur elementet qe percaktohet ne nenin 26 te LPP.

BAZA LIGJORE

Ne Njoftimin Artulimin e Dhenies se` Kontrates, Autoriteti Kontraktues ka dhene arsyetim té pergjithshem, duke u referua ne nenin 65, paragrafi 1 te LPP, i cili percaktort disa raste kur nje Operator Ekonomik nuk eshte i pranueshem per te marr pjese ne nie tender publik. Rrjedhimisht Autoriteti Kontraktues ka deshtuar te ta beje te qarte se cili nga rastet e percaktuara ne nenin 65 te LPP eshte konsideruar giate manjes së Vendimit, perkunder faktit qe nje gje e tille eshte obligative sipas nenit 48 te Ligjit per Proredu.ren e Pergjithshme Administrative. Rrjedhirnisht, Autoriteti Kontraktues nuk ka here të qarte dhe nuk ka arsyetuar Vendimin per Anulim duke ja veshtiresuar mbrojten Operatotit Ekonomik dhe procesin ankimor, referimi ne nenin 65, parag. 1 të LPP ne Njoftimim per Anulim, eshte bere perkunder faktit qe Operatori Ekonomik ka kaluar rte te gjitha fazat procedurale të tenderit publik, do te thote ka shtierr fazat te cilat Autoriteti Kontraktues i ekzkuton ne menyre qe te konfirmoj se nuk ekziston asnjë rrethane percaktuarnë nenin 65 te LPP, rrjedhimisht bazuar në faktin qe Autoriteti Kontraktues ka shpalle fitues te teriderit Operatorin Ekonomik dhe te dyja palët kane konfinnuar draftin final të kontrates, Nkoftimi per Anulim dhe arsyetitni eshte kunderthertes me procesin e ekzekutuar nga vet Autoriteti Kontraktues dhe i paarsyeshëm. Autoritefi Koatraktues nuk ka pasur asnje ndalese per nënshkrimin e kontratës, rrjedhirnishttë gjitha kushtet ligjore te Pèrshkruara x nenm 26, paragrafi 4 i LP-se janë pennbushur. Pr me teper, sic jeni ne dijeni, drafti final I kontrates eshte konfirrnuar nga te dyja palet si dhe Operatorit Ekonomik eshte dorezuar Pjesa- II- Pershkrimi i Çmirneve, kerkesa per ekzekutimin e Garanizionit, si dhe infonnatatnë lidhur me kohen e liferimit. Prandaj, bazuar nenin Neni 15 te Ligjit per Marredhenien e Detyrimeve, Kontrata eshte e e lidhur ku palët kontraktuese jan marre vesh per elementet thelbesore te kontrates. Andaj, Autoritei Kontraktues rezervon të drejten e shkpujes se kontrates vetem ne rrethanat e perraktuara ne nenin 28 te Kontrates me Numer KEK-21-5233-144/0439, e fituar me tender publik nga Operatori Ekonomik.

III. KONKLUDIMI DHE KERKESA

Operatori Ekonomik, kishte plotesuar t gjitha kriteret e kerkuara në dosjen e tenderit kështu duke u shpallur fitues. Ne menyre që të pembush detyrimet kontraktuale, Operatori Ekonornik pas konfinnimit te kohes së liferimit prej 120 ditesh, ka ndermarr veprime të menjehershrne duke bere porosine me fumizim ne baze te dokumentit Pjesa- Pershkrimi cmimeve e cila ishte pjese perberese e Kontrates kryesore. Operatori Ekonomik ka hyre ne obligime financiare kundrejt Furnitorit per piesen e pare te porosise ne vlefen totale prej 149,53170 euro. **Prove: Profatura dhe Gancioni Bankar.**

Autoriteti Kontraktues, perkunder faktit që ka ndermarr të gjitha veprintet dhe ka kaluar ne gjitha fazat e kerkuara gjate nje procesi te tenderimit publik,, keshtu, duke konfirmuar draftin final te kontrates, konfinnimit të kohes së liferimit si dhe kerkesave per konfimim te valididetit të ofertes, veprirne keto te cilat konsistojne nje marredhenie kontraktuale, perfundimisht ne menyre Jo te dreite dhe ligjore ka marr vendirn per anulimin e dhenies së kontrates, duke i shkaktuar Operatorit Ekonomik dem direkt finantaiar r ne vleren prej 149,533.70 euro, vlere kjo e cila ekzekutohet nga Furnitori per porosirte e bere nga Operatori Ekonomik sipas kerkeses së Autoritetit Publik. Per me teper, demi I Operatorit Ekonomik konsiston edhe ne fitirnin e humbur, perkatesisht në fitirnin i cili pashmangshmerisht do te realizohej si pasoje e realizimit te Kontrates. Konsiderojrne qe njoftimi

per anulimin e dhenies së kontrates nuk eshte i drejte, marr per baze faktin që te njejtit i mungon arsyeshmeria si dhe faktin që tashme në perputhje me dispozitat e Ligjit per Manedhenien e Detyrimeve, Kontrata konsiderohet e lidhur dhe njoftimi per anulim te dhenies se kontrates eshte i vonshem dhe nuk mund te kete pasoja juridike. Prandaj, bazuar ne gjithe sa u tha me siper si dhe duke marre parasysh dispozitat ligjore te cituara ne kete Kerkese, keskojine nga Autoriteti Kontraktues, te merr kete:

VENDIM

Të ANULOJ, VENDIMIN per Anulimin e Dhenies se Kontrates i dates 29 04.2022.

Te OBLIGOJ Autoritetin Kontraktues qe te ekzekutoj Kontraten me Nuinér KEK-21-5233-1-1-1/C1439 duke pranuar furnizirnin sipas objektit dhe qèllirnit të kesaj Kontrate nga Operatori Ekonomik.

Kerkoj nga OSHP qe ne përputhje me nenin 109 te LPP-se te shqyrtoj kete ankese dhe te nxjerr Vendim [er te njëjtën brenda afatit ligjor te përcaktuar.

KRITERET PËR VLERËSIM

Te vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore.

Autoriteti kontraktues nuk ka eleminuar OE (nuk ka Leter Standarde per eleminim) por ka bere anulimin e aktivitetit te prokurimit pasi eshte bere njoftimi per dhënie te kontratës me kete arsyetim:

"Anulohet tenderi, sepse sipas specifikimit teknik te DT dhe ofertes te OE pjesemarres nuk eshte ne pajtushmeri me nenin 65 te LPP-se"

OE ankues pretendon se anulimi i aktivitetit te prokurimit eshte bere pa baze ligjore dhe pa arsyetimet përkatëse te cilat parashihen ne ligjin per Proceduren e Pergjitheshme Administrative.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës se OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Komisioni i vlerësimit pas kontrollimit ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit te tenderëve per kete aktivitet te prokurimit, konsideron se oferta e OE "ORTU" i plotëson te gjitha kërkesat e DT dhe eshte i përgjegjshëm. Komisioni i vlerësimit deklaron se aktiviteti i prokurimit eshte udhëhequr duke respektuar dispozitat e LPP-se dhe RRUOPP dhe rekomandon per kontrate OE "ORTU" SHPK te shpërblehet me kontrate per kete tender ne vlere prej 319.264,21 €.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Nuk ka marre eksperti shqyrtues informacion shtese.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

OE ankues është pale e interesit ne këtë aktivitet te prokurimit**.**

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjti është dhënë vlerësim tjetër).

Nuk ka pasur vendim te me hershem për këtë aktivitet te prokurimit**.**

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

Nuk kemi devijim nga praktikat e me hershme.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "ORTU" SHPK

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Pretendimi i OE ankues eshte se AK e ka anuluar aktivitetin e prokurimit ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se sepse ka deshtuar te ta beje te qarte se cili nga rastet e percaktuara ne nenin 65 te LPP eshte konsideruar gjate marrjes së Vendimit, perkunder faktit qe nje gje e tille eshte obligative sipas nenit 48 te Ligjit per Proreduren e Pergjithshme Administrative. Operatori Ekonomik nuk ka marr pjese ne hartimin e dosjes tenderuese me numer te prokurimit KEK-21-5233-144, por qe Autotiteti Korntraktues si njedhoje e shërbimit nga Operatori Ekonomik brenda komizave kontraktuale të tjera, po e penalizon Operatorin Ekonornik duke mos nenshkruar Kontraten per Fumizim me pjese nderrimi per vmcit hidraulik teleskopik Liebherr, perkunder faktit që asnje rrethane ndaluese nuk eshte identifikuar dhe per me teper jane permbushur elementet qe percaktohet ne nenin 26 te LPP. Lidhur me kete pretendim ankimor eksperti shqyrtues ka kete mendim.

Fillimisht po japim nje përshkrim te shkurtër për vijueshmërin e këtij aktiviteti të prokurimit. Autoriteti kontraktues ka bërë ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve dhe sipas komisionit vlerësues eshte rekomanduar per dhënie te kontratës OE ankues. Raporti i vlerësimit te ofertave e kualifikon si tenderues te pergjegjeshem ofertën e OE ankues, po ashtu rekomandimi dhe raporti i komisionit te vlerësimit te oferta është aprovohet dhe nënshkruhet nga zyrtari përgjegjës i prokurimit me datën 11.10.2021. Ne te njëjtën datë AK publikon në platformën e KRPP Njoftimin mbi vendimin e AK-se dhe dhe njofton OE ankues me Letrën Standarde për tenderuesin e suksesshëm.

Me datën 19.10.2021 AK ka bërë Njoftimin për dhënie të kontratës me të cilën është shpërblyer me kontratë OE ankues me vlerën e ofertës prej 319.264,21 €. Me datën 19.04.2022 autoriteti kontraktues bënë njoftimin për anulimin e dhënies së kontratës, në të njëjtin ditë AK bënë edhe njoftimin për anulimin e aktivitetit te prokurimit. Ne Njoftimin per anulimin e dhënies se kontratës AK jep kete arsyetim:

"*Një rekomandim i lëshuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik kërkon anulimin e njoftimit për dhënie te kontratës*"

Mirëpo AK nuk thekson se cili eshte ai rekomandim i KRPP-se që kërkon anulimin e njoftimit për dhënie te kontratës dhe për cilat arsye. Ndërsa ne Njoftimin per Anulimin e aktivitetit te Prokurimit, AK jep kete arsyetim:

"*Një shkelje e LPP-se ka ndodhur apo do të ndodh në proceduren e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit*"

Edhe ne kete rast AK **nuk jepet arsyetim** se cila shkelje e LPP-se ka ndodhur e cila detyron AK ta bëjë anulimin e aktivitetit te prokurimit. Pas anulimit te aktivitetit te prokurimit, OE ankues paraqet Kerkesen per rishqyrtim ne AK. Ndersa me datën 28.04.2022 AK nxjerr vendimin dhe Refuzon Kerkesen per Rishqyrtim te OE ankues si te pa bazuar me arsyen se:

"*Ky aktivitet i prokurimit anulohet sepse sipas specifikimit teknik te dosjes se tenderit dhe ofertës se OE pjesëmarrës nuk eshte ne pajtueshmëri me paragrafin 1 te nenit 65 te LPP-se*".

Eksperti shqyrtues konstaton se AK **nuk ka arsyetuar** vendimin per refuzimin e kërkesës per Rishqyrtim siç parashihet me nenin 108/A pika 12 e LPP-se sepse nuk janë dhënë dëshmitë dhe provat në mes specifikimit teknik të DT dhe ofertes se OE annkues te cilat janë ne papajtueshmeri me paragrafin 1 te nenit 65 te LPP-se. Shtrohet pyetja cilat janë veprimet e OE ankues ose ndonjë punonjësi, drejtuesi, menaxheri ose drejtori te tije që kanë ndikuar ne shkeljen apo mos respektimin e paragrafit 1 te nenit 65 te LPP-se.

Po ashtu para anulimit te nje aktiviteti te prokurimit, Operatoret ekonomik pjesëmarrës duhet te njoftohen me letrën standarde per eleminim siç parashihet me nenin 54 te LPP-se pika 1.2, njoftimi do të saktësojë mungesat në një tender të tillë. Dokumentet e prokurimit duhet të përmbajnë të paktën të gjitha informatat, kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përcaktuara në formularët standard si **informacion të detyrueshëm** dhe në përgjithësi të jenë të qartë dhe të kuptueshme për OE të interesuar. Nuk është bërë një njoftim i tillë i OE ankues nga ana e AK-së. Prandaj eksperti shqyrtues e vlerëson si pretendim ankimor të **bazuar**.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Autoriteti kontraktues ka bërë anulimin e aktivitetit te prokurimit edhe pse ofertën e OE anukues e ka kualifikuar si te përgjegjëshme. Nuk e ka njoftuar OE me letrën Standarde për eleminim siç parashihet me nenin 54 të LPP-së. Në njërën anë oferta vlerësohet si e përgjegjëshme, në anën tjetër anulohet aktiviteti i prokurimit. Ka nje diskrepancë (kundërshtim) në mes të vendimeve të AK.

Po ashtu AK në vendimin e datës 28.04.2022 nuk ka **dhënë arsyetimin e nevojshëm dhe shkaqet të cilat kanë ndikuar për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim** të OE ankues siç parashihet me dispozitat të nenit 108/A pika 12 të LPP-së. Arsyetime te tilla janë të obligueshme edhe me nenin 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithëshme Administrative.

Eksperti shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit te pretendimit ankimor i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues "ORTU" SH.P.K të **aprovohet** si e bazuar.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të bëjë **Rivlerësimin** e ofertave për aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me pjesë ndërrimi për vinç hidraulik teleskopik Liebherr"** me nr. te prok. KEK-21-5233-111 në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues KEK,
- Panelit Shqyrtues OSHP dhe
- OE ankues"ORTU" SHPK